# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-475086**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kasami: Lidhja Tetovë–Prizren ende pa projekt të përfunduar |
| ADRESA | `https://albeu.com/maqedoni/kasami-lidhja-tetove-prizren-ende-pa-projekt-te-perfunduar/1030333/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 06:30:20 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 06:25:26 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `1f82d12cec0e9e24cc6c66ab72f73ae8809ee2560daa9ed7112d94a081c5afc2` |
| TEKSTI | `e4c64dd98e02579bfb7cc4c1c259dbe67ed12a9bf5c2728d7e8b4749eb4ae7d9` |
| PAMJA | `e6e1830e30599a538a5ed6ca939b02cb45ef4622903828cafe6d97d8d7885c86` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ea7ed94c8e60e985f797d3952ab50015961c62384f9bd8695f60eeefa9fdffc2` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c6e9ce599dcf050571ac11f5fe8a3879623b3af12e442f4fee76de6471dba328` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ea7ed94c8e60e985f797d3952ab50015961c62384f9bd8695f60eeefa9fdffc2`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Kasami: Lidhja Tetovë–Prizren ende pa projekt të përfunduar



Ndërsa Kosova ka nisur hapa konkretë për ndërtimin e lidhjes rrugore Prizren–Tetovë, në anën tjetër të kufirit ende mungon projekti i plotë për trasenë. Pavarësisht kësaj, një pjesë e rrugës po ndërtohet në drejtim të Shipkovicës, edhe pse projekti përfundimtar i gjithë aksit nuk është përmbyllur. Kryetari i Tetovës, Bilall Kasami, thotë se segmenti aktual do të harmonizohet më vonë me projektin final, por konfirmon se deri tani nuk ekziston një projekt konkret.

"Ne nuk kemi projekt komplet për trasenë e rrugës. Ka pasur një studim, i cili ka ofruar disa opsione, dhe ne tani po realizojmë një segment të asaj traseje. Në bazë të studimit, rruga shkon nga Tetova deri në fshatin Shipkovicë, ku janë paraparë disa opsione. Njëri prej tyre është edhe ky që po realizohet. Për momentin nuk ka projekt konkret. Në momentin kur të realizohet projekti, do të përshtatet edhe traseja e rrugës me rrugët ekzistuese dhe do të parashihet edhe dalja për në Shipkovicë.", deklaroi kryetari i Komunës së Tetovës, Bilall Kasami.

Sipas Kasamit, për ndërtimin e rrugës dhe tunelit janë analizuar disa alternativa. Dy qeveritë kanë zgjedhur variantin që parashikon një tunel rreth gjashtë kilometra të gjatë, por edhe kjo zgjidhje, thekson ai, ende nuk është shndërruar në projekt të plotë.

"Për disa zgjedhje janë ofruar disa opsione. E dini se edhe tuneli, në bazë të studimit që punohet sot për rrugën Tetovë–Prizren, ka pasur tre opsione. Një opsion ka qenë pa tunel, të shkohet në majë të kodrës, një opsion ka qenë me tre kilometra dhe gjashtë kilometra. Për momentin, qeveritë e dy shteteve kanë vendosur opsionin me tunel gjashtë kilometra. Prandaj, rruga nuk është projekt konkret, ka studim dhe ka projekt ideor.", u shpreh Kasami.

Ndërkohë, në Kosovë po vijojnë përpjekjet për realizimin e rrugës Prizren–Tetovë. Gjatë takimit në Nju Jork me kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Hristijan Mickoski, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kërkoi përshpejtimin e procedurave për tunelin që do të lidhë Prizrenin me Tetovën.

të fundit/


Kasami: Lidhja Tetovë–Prizren ende pa projekt të përfunduar


Mbappe pritet të jetë në dispozicion të Real Madridit për sfidën nd…


Dosja 23" mund të kthehet në një hap të rëndësishëm kundër…


Pesë persona në pranga pranë bazës amerikane në Britani,…


Këmbimi valutor/ Me sa blihen e shiten dollari dhe euro, çfarë ndod…


Pse viktimat e krimeve të luftës mbeten në hije?


Procesi gjyqësor ndaj 21 personave për dëbimin masiv të…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

"Theksova rëndësinë e përshpejtimit të procedurave për tunelin Prizren-Tetovë, si projekt me rëndësi të veçantë për qytetarët, sikurse edhe për zhvillimin e turizmit dhe ekonomitë e të dyja vendeve.", shkruan Kurti në rrjetin e tij në Facebook.

Vlera e projektit llogaritet në rreth 200 milionë euro dhe financimi pritet të bëhet bashkërisht nga dy qeveritë. Përfundimi i tij do të shkurtonte ndjeshëm distancën mes Tetovës dhe Prizrenit, duke mundësuar një lidhje më të shpejtë e më të drejtpërdrejtë dhe duke krijuar hapësirë për zhvillimin e ekonomisë dhe turizmit. Megjithatë, përderisa Kosova flet për përshpejtim të procedurave, në anën tjetër të kufirit procesi mbetet ende në fazën e studimeve, alternativave dhe projektit ideor.

Shtuar më 28.09.2026 08:25

Tags: Bilall Kasami , Tetovë-prizren



Aksion policor në lokalet e Shkupit, pranga tetë personave përfshirë tre t…


Ahmeti: Çlirimtarët nuk mund të dënohen në emër të shqiptarëve


Vigenin akuzon Mickoskin për bllokimin e ndryshimeve kushtetuese…


Maqedonia e Veriut synon të sigurojë 1.3 miliardë euro hua në tregjet…


Vjedhje në Çair, autorët marrin pajisjen e kamerave nga stacioni teknik


Maqedonia e Veriut regjistroi 741,446 vizitorë gjatë shtatë muajve të pa…


Risteski: Karta digjitale do t'i japë fund pritjeve të studentëve në sportele


Aliti: Kërkuam drejtësi, por morëm zhgënjim, Specialja u shndërrua në gjykatë…

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko... Kërko

**Kryesore**
- Erion Veliaj
- Free Esim
- Zgjedhjet 2025
- Belinda Balluku
- SPAK
- Kombëtarja

**Kategori**
- Lifestyle
- Showbiz
- Tech
- Shëndetësi
- Argetim
- Enciklopedi

**Linqet**
- Live tv shqiptare
- Moti në Shqipëri
- Travel
- Horoskopi
- Livescore
- News from Albania

**Tags**
- Edi Rama
- Albania News
- Ilir Meta
- Piranjat
- gazeta, tv, portale
- Sali Berisha

**Moti**
- Moti në Tiranë
- Moti në Prishtinë
- Moti në Shkup
- Moti në Durrës
- Moti në Prizren
- Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com |

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.